

eppc kërkon një Area Manager për klientin e saj, i cili është një ndër kompanitë më të njohura ndërkombëtare të Retail-it në vend, në industrinë e modës.

### Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Diplomë Universitare në Administrim Biznes;
- Përvojë e mëparshme jo më pak se 5 vjet në Retail si Area Manager (*domosdoshmëri*);
- Njohje të shkëlqyer të gjuhës Angleze;
- Njohuri të avancuara të MS Office;
- Aftësi të mira të menaxhimit të kostove dhe buxhetimit;
- Aftësi të shkëlqyera menaxhimi, komunikimi dhe negocimi;
- Disponueshmëri për të udhëtuar.

### Përgjegjësitë Kryesore:

- Planifikon dhe harton objektivat përkatës dhe planin e veprimit me qëllim maksimizimin e performancës së shitjeve;
- Njohje shumë e mirë dhe studim i tregut dhe konkurrencës;
- Propozon hapjen e pikave/dyqaneve të reja në vendodhjet e duhura;
- I ofron ekipit drejtues propozime buxhetore dhe merr masat e nevojshme me qëllim realizimin e planeve të buxhetit;
- Kontrollon proceset operacionale në dyqanet që ka nën përgjegjësi me qëllim që ato të jenë konform rregulloreve dhe udhëzimeve, legjislacionit përkatës si dhe vizionit, misionit dhe vlerave të kompanisë;
- Identifikon nevojat e konsumatorit, i përcjell ato tek njësitë përgjegjëse me qëllim krijimin e sistemeve të nevojshme për të siguruar kënaqësinë e konsumatorit;
- Motivon dhe supervizon stafin me qëllim realizimin e objektivave dhe krijimin e një kulture korporative pune.

### Të dhënat:

Pozicioni:	Area Manager;
Vendndodhja:	Tiranë;
Orari:	40 orë në javë;
Raporton tek:	Country Manager;
Udhëtime pune:	Po;
Pagesa:	Në nivel drejtuesi;
Kontrata:	Sipas Kodit të Punës;
Aplikimet mbyllen:	18.05.2015

### Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj dhe dokumentet e tjera shoqëruese duke *përmendur pozicionin për të cilin aplikoni* në adresën e e-mail-it:

[recruitments@eppc.al](mailto:recruitments@eppc.al)

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj dhe dokumentet shoqëruese do të kualifikohen. Tek ne CV-ja juaj është e sigurt dhe trajtohet në konfidencialitet të plotë.